



Republika e Kosovës



Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)-

01.Nr. zyrtar/ 2020

Procesverbal

Takimi i III-të dhe i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020

Më 06.08.2020

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Halim Shehu, Komandant i Policisë-Kaçanik

Liridon Selimi, përfaqësues i FSK-së

Kjani Sallahu, FOJK

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Ramadush Osmani-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencia

Lirije Luta- Komiteti për Komunitete

Zahir Doda-Drejtor i DAK

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Fidaim Fazliu-Bashkësia Islame

Fadil Guri -ZKKK

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Besim Ilazi** i cili prezantoi pikat e rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut
3. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për sigurinë
4. Të ndryshme

1.Miratimi i procesverbalit nga takimi kaluar

-Proces verbali u miratua nga të gjithë të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut

-Rreth pikës së dytë të rendit të ditës komandanti i policisë tha se situata në përgjithësi gjatë kësaj periudhe ndërmjet dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile.

Shqetësuese është situata me virusin COVID-19 pasi që kohëve të fundit është rritë rasti i të infektuarëve me këtë virus . Për mos respektim të masave të vendosura nga qeveria në këtë periudhë janë ndaluar 48 qytetarë , 10 raste janë ndëshkuar ndaj lokaleve biznesore . Në këtë periudhë gjithashtu ka pasur edhe vjedhje nëpër shtëpi ku kemi kapur një grup grup personash që janë involvuar në këtë vepër me çrast u janë gjetur gjësende me vlerë dhe rastet janë në procedurë . Në fshatin Nikaj është kapur një person që është nga komuna e Podujevës i cili ka marrë pjesë në vjedhje ku i është gjetur ari dhe rasti është në procedurë .Kohëve të fundit me shtimin e masave për parandalimin e virusit COVID-19 është rritur vetdijësimi i qytetarëve për vendosjen e maskave .Kemi marrë një njoftim se nga dita e djeshit xhamitë kanë filluar me ritet e tyre duke i respektuar edhe masat ndaj situatës Një grup personash para disa ditësh kanë tentuar të bllokojnë komunikacionin në qendër të qytetit duke u falur në rrugë dhe në kemi reaguar dhe këta persona i kemi marrë i kemi intervistuar dhe rastin e kemi në procedurë e sipër . Bashkëpunimin në menagjimin e situatës e kemi shumë të mirë me inspektorët komunal dhe me të gjithë akterët tjerë të sigurisë .

J.Selimi – nuk di se sa jeni të informuar ju si stacion i policisë lidhur me një incident që ka ndodhur në Kaçanik të Vjetër ku ka pasur gjuajtje armësh dhe një person ka pësuar lëndime .

K.i Policisë – ka pasur një tentim vrasje dhe personi që ka kryer veprën është nën arrest .Situata nuk është e mirë rreth këtij rasti ngase një person ka pësuar gërvishtje .

Kryetari – Këshilli Emergjent mbanë takime të shpeshta në lidhje me menagjimin e situatës me pandeminë dhe deri më tani në bazë të informacioneve që kemi marrë nga IKSHP të infektuar në komunën tonë që nga fillimi i pandemisë rezultojnë 63 persona ku shumica prej tyre edhe janë shëruar . Disa familje janë vetizoluar dhe krahasuar me disa komuna tjera ne qëndrojmë më mirë . E pranoj që masat e vendosura nga IKSHP nuk e kanë pasur efektin e duhur por që vendimet duhet respektuar . Pjesa më shqetësuese është gastronomia e cila me shkurtimin e orarit të punës ka dëmtuar shumë këtë pjesë të zhvillimit ekonomik . Disa pronarë të gastronomive nuk kanë respektuar masat dhe ndaj tyre janë marrë edhe masa . Duhet të gjejmë mirëkujtim që në këtë situatë ti respektojmë masat e ndërmarrura nga qeveria dhe gjithë së bashku të kontribuojmë në tejkalimin e situatës .

K.Sallahu-duhet pranuar se situata është shqetësuese në lidhje me pandeminë , ku kemi rritje të të infektuarëve . Mendoj se duhet të mobilizohemi lokalisht ngase kapacitetet e nivelit qendrorë janë të pakta . Kur them mobilizim lokal e kam fjalën që ne të bëjmë një strategji në aspektin logjistik dhe duke bërë fushata vetdijësuese . Të përdoren kapacitetet e shoqërisë civile me fushata vetdijësuese duke përqarë mesazhe tek qytetarët në lidhje me situatën .

Kryetari :çdo iniciativë është e mirë edhe pse mediat për çdo ditë po e bëjnë një gjë të tillë . Shtabi është funksional dhe ne kemi marrë masat me kohë . E kemi palestrën në dispozicion nëse paraqitet një situatë e rënduar .

K.Sallahu-më intereson të dijë se a ka shtabi emergjent një zëdhënës që mundë të na jep informacione të detajuara në lidhje me rastet e të infektuarëve .

Kryetari-me të marrë informacionet nga IKSHP ne informatat e detajuara i përcjellim policisë dhe askujt tjetër ngase këto informata duhet të jenë konfidenciale .

K.i Policië – Me këto kapacitete që kemi ne i kontaktojmë kohë pas kohe familjet e prekura ngase nuk egziston mundësia që gjat gjithë kohës ti mbajmë nën vëzhgim të gjitha rastet . Edhe unë mendoj se informatat duhet të jenë konfidenciale .

L.Luta- Ne si komunitet për komunitete kemi planifikuar që së shpejti të fillojmë një fushatë vetdijësuese për qytetarë në lidhje me situatën e krijuar me virusin COVID-19

3. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për sigurinë

-Në pikën e tretë të rendit të ditës Kryetari tha se në bazë të informacioneve që kam marr nga komisioni për hapjen e kutive të ankesave , në kutinë e ankesave në objektin e komunës nuk është gjetur asnjë ankesë që ka të bëjë me sigurinë e përgjithshme të qytetarëve

-R. Osmani – shumica e ankesave të qytetarëve drejtohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia . E kemi të miratuar një rregullore mbi taksat dhe roli i administratorëve është i përfshirë në këtë rregullore Një pjesë e qytetarëve nuk po e respektojnë autoritetin e administratorëve . Në këtë rregullore parashihet që autoriteti i administratorëve të respektohet . Ne në këtë rregullore kemi paraparë që kërkesat që ka një lokalitet të bëhen vetëm përmes administratorëve ngase ata janë të zgjedhur nga vet qytetarët dhe duhet që hirarkia të respektohet .

Sh.Abazi-më intereson të dijë se në qytet ku mundë të drejtohem ngase në një zonë ka administrator e zona tjetër nuk ka .

Kryetari – rregullorja tregon që administratori aktual është legjitim deri sa të zgjedhet i riu .

J.Selimi –më pëlqen idea për autoritetin e administratorit ngase me këtë ne edhe mundë të faktorizohemi .

K.Sallahu-nuk është reale nëse thuhet se nuk ka ankesa të qytetarëve . Nuk di se sa është funksional komisioni për hapjen e kutive të ankesave dhe që nuk duhet të bazohemi vetëm në kutitë e ankesave mbrenda objektit komunal por që duhet të gjinden forma tjera me qëllim që ne të informohemi mbi problemet që ballafaqohen qytetarët .

Kryetari:ankesa e kërkesa të qytetarëve ka por që ato nuk i fusin në kutitë e ankesave por gjejnë forma tjera më të shkurta duke u drejtuar në zyrën e kryetarit dhe në drejtoritë komunale .

R.Osmani-ka kërkesa të ndryshme që qytetarët gojarisht bëjnë nëpër drejtori por që nuk i bëjnë përmes kutisë së ankesave . Gjithashtu ata kërkesat i bëjnë përmes zyrës së pritjes të protokoluara dhe përgjigjen e marrin mbrenda periudhës një mujore .

4. Të ndryshme

-Në pikën e fundit të rendit të ditës fjalën mori kryetari i Bashkësisë Islame në Kaçanik, **Fidaim Fazliu** i cili i ngriti disa shqetësime :vonesa për ceremoninë e vorrimeve për personat që vdesin në spitale ku për këtë qështje shoh se nuk ka koordinim të institucioneve që mirren me këtë punë . Të gjitha xhamitë në natën e bajramit janë mbyllë me urdhër të IKSHIP-së dhe nga dita e djeshit janë hapur sërish gjithmonë duke respektuar masat që janë ndërmarrë nga niveli qendrorë.Shqetësuesë është sjellja e disa individëve që vijnë e kryejnë ritet fetare në xhami e që po na injorojnë dhe nuk po sillen në bazë të rregullave që ka ky institucion fetarë . Falënderoj policinë që çdo herë që kemi shfaqur ndonjë shqetësim nga këto grupe , janë marrë me to .Veprimet e tyre janë që i thejnë ligjet , krijojnë pasiguri dhe duhet të jemi syqelë në trajtimin e tyre .

K.Sallahu-problematika me mbeturina ndërlidhet me ankesat e qytetarëve që kanë ndaj kompanisë „Pastërtia” e në këtë rast kjo ankesë vë nga banorët e fshatit Biçec .Në një pjesë të fshatit për dy javë kjo kompani nuk e ka kryer shërbimin dhe si pasojë mbeturinat janë shpërndarë gjithkrah nëpër rrugë .Për të pasur një ambient të pastërt duhet që edhe menagjimi i mbeturinave të jetë në nivel . Komuniteti i kësaj ane po ankohet tek unë si administrator ngase unë kam qenë si garantues në kohën kur kjo pjesë ka hyrë në listën e inkasimit nga kompania . Mendimi im është se kompania ka kapacitete të pa afta për të menagjuar situatën në lidhje me mbeturinat dhe në këtë rast kërkoj nga organet komunale që të mirren me këtë qështje pasi që gjendja nuk po ndryshon për të mirë .

Liridon Selimi – sot zëvendësoj kolegën Lulzim Ukën dhe nuk kemi diçka për të raportuar por që FSK gjithmonë është e gatshme për bashkëpunim për çdo pikë kritike nëse paraqitet nevoja .Këto ditë është paralajmëruar se do të ketë reshura të mëdha shiu dhe ne jemi të gatshëm për të ju ndihmuar me kapacitetet tona në rast se kërkohet kjo ndihmë nga ana e juaj .

R.Osmeni-kemi informacione se mundë të ketë reshura të dendura të shiut dhe ne si komunë i kemi marrë masat për tu përballur me ndonjë vërshim nëse do të ketë , por për momentin nuk shohim ndonjë rrezik për ndonjë vërshim të mundshëm. Ne jemi për çdo ditë në teren dhe kemi ndërhyrë në disa pika ku kemi paraparë rrezik potencial.Për çdo situatë të jashtëzakonshme ne do të jemi në kontakt me çdo aktor të sigurisë .

REKOMANDIMET:

- Mobilizim lokal në përballje me pandemin COVID-19 në aspektin logjistik dhe fushatë vetdijësuese
- Të përcillet lëvizja e personave të infektuar nga virusi COVID-19 e që kanë marrë rekomandim për vetizolim
- Të faktorizohen administratorët e lokaliteteve karshi kërkesave të qytetarëve
- Të evidentohen të gjitha kërkesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me sigurinë publike
- Koordinim më i mirë i institucioneve rreth procedurave të vorrimit në rastet që kanë të bëjnë me virus COVID-19
- Të mirren masa ndaj personave që nuk respektojnë ligjet dhe nuk ju përmbahen rregullave të institucioneve në përgjithësi
- Të ju ipet vërejtje kompanisë „Pastërtia” në lidhje me menagjim të dobët në mbledhjen e mbeturinave
- Kërkohet bashkëpunim edhe më i mirë në menagjimin e situatave të ndryshme me të gjithë akterët e sigurisë

Pas këtyre diskutimeve Kryetari mbylli takimin për tu takuar në terminin e radhës .

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka

A handwritten signature in blue ink, corresponding to the name Fatmir Qaka.